



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.967/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A., me numër unik identifikues ... dhe seli në Prishtinë, rr. "...", ... Lakrishtë, kundër debitorit "F...", Sh.P.K., me numër të biznesit ... dhe seli në Prishtinë, rr. "... nr...", duke vendosur sipas prapësimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 25/21, i lejuar më datë 29.09.2021, nga Përmbaruesi Privat Isak Islami, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "F...", Sh.P.K., me numër të biznesit 71242331, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 25/21, i lejuar më datë 29.09.2021, nga Përmbaruesi Privat Isak Ismaili, ANULOHET

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë, mbi bazën e dokumentet të besueshëm, faturës nr. 01/Qer20, të datës 19.06.2020, ka lejuar urdhrin për përmbarim P.nr.25/21, të datës 29.09.2021, me të cilin është urdhëruar debitori "F...", Sh.P.K., që në afat prej 7 ditës nga pranimi i këtij urdhrit, t'ia paguaj kreditorit shumën në lartësi prej EUR 2,573.64, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk ka tipare të përmbarueshëmrisë, ngase e njëjta nuk është nënshkruar nga debitorit si dhe është dorëzuar në kopje. Tutje, debitori ka shtuar se këtë faturë nuk e ka pranuar më parë, ndërsa gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhri për përmbarim të prishet.

Në përgjigje në prapësim, kreditori ka theksuar se qëndron në tërësi pranë propozimit për përmbarim, ndërsa ka kundërshtuar prapësimin e debitorit të paraqitur ndaj urdhrin përmbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, pika 1.3 e njejtë nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti, përkatësisht fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokumenti besueshëm. Nga provat që gjenden në shkresa të lëndës, rezulton se kreditori nuk ia ka dorëzuar me rregull debitorit faturën, ngase të njejtës i mungon nënshkrimi apo vula e pranimit e debitorit, e poashtu e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim në kopje të pavërtetuar. Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit, ndërsa ky i fundit i ka pranuar faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri, dhe është njoftuar me detyrimin që rrjedhë nga kjo. Prandaj, fatura e paraqitur në kopje të pavërtetuar dhe e pa pranuar nga debitori, si e tillë, paraqet dokument të njëanshëm dhe rrjedhimisht nuk është e përshtatshme për përmbarim.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, përkatësisht fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, nuk ka

tipare të përmbareshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbareshit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 967/22, datë 30.03.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.